



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	01. 11. 2023	3	viti god year
Organ / Jedinica Org. / Unit	SKUPSHTICA	6821/2023	1/5
Organ / Jedinica Org. / Unit	Dr. Prof. Dr. Prof.	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicitua Quantity



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

**A.nr.1170/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti, anëtarë; me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1170/202, të datës 18.09.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër organit të punësimit Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.11.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1170/2023, e datës 18.09.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

**A r s y e t i m**

Ankuesi [redacted] (këtu e tutje vetëm ankuesi), më datë 18.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6133/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 13.09.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për ndërprejten e procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër të referencës RN00011216, për pozitën e punës “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa,

kjo e fundit më datë 02.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 6133/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 13.09.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për ankuesin; Emailin e datës 18.09.2023 nga ankuesi për [ankesa.kpmsk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsk@rks-gov.net); Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.10.2023; Konkursin me numër Reference RN00011216 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* për Ministrinë e Mbrojtjes të datës 14.03.2023 të shpallur nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 27.04.2023; Njoftimin e datës 31.08.2023; Vendimin me Nr. 04/73 të datës 30.04.2023 për emërimin e Komisionit Shtetëror të Pranimit; Vendimin me Nr. 04/141 të datës 28.04.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të datës 30.04.2023; Vendimin me Nr.06/145 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të datës 28.04.2023; Emailin e datës 04.09.2023 nga I.P për ankuesin për ftesë për test me shkrim; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 12.09.2023; Lista nga poentimi i intervistës; Vendimi me Nr.prot:1270 i datës 10.08.2023; Njoftimin për ndërprerjen e procedurës i datës 14.09.2023 nga I.P për ankuesin; Njoftimin për pakënaqësi i datës 14.09.2023 nga ankuesin për I.P; Kërkesa e datë 03.05.2023 nga ankuesi për Sh.H; Njoftimi i datës 28.04.2023 nga Sh.H për ankuesin; Regjistrin e pikëve nga intervista; Aplikacionin e kandidatit M.B i datës 19.04.2023, Diplomën me Nr.551, Shtojcën e Diplomë me Nr. Port:1304, Vërtetimin e datës 01.09.2011, Vendimin me Nr. 05/84 të datës 15.04.2016, Vërtetimin e datës 25.08.2020, Vërtetimin me Nr.107/2023 të datës 14.04.2023, Rekomandimin e datës 15.06.2020, Letër Motivimi e datës 18.04.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 16.04.2023, Dokument identifikimi, CV-në, Letër rekomandimi e datës 29.06.2020, Referencë e datës 03.01.2007, Certifikatën MO7110, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për 01.01.2017-14.04.2023, Certifikatën e datës 30.11.2000, Certifikatën 05-07.06.2018, Certifikatën për 11-15.03.2019, Certifikatën për 13-31.05.2019, Certifikatën për 04-08.11.2019, Certifikatën për 24-28.02.2020, Certifikatën për 02-06.03.2020, Certifikatën për 04-22.10.2021, Certifikatën për 05-07.04.2022, Certifikatën për 23-26.05.2017, Licencë e datës 18.01.2004, Certifikatën e datës 21.02.2001, Certifikatën e datës 15.03.2001, Diplomën me Nr. 26, Certifikatën për periudhën 11-13.09.2001, Vërtetim me Nr. prot:181/10 të datës 15.10.2011, Letër rekomandimin e datës 09.01.2007, Certifikatën për 18-20.10.2016, Vërtetimin e datës 18.12.2002, Vendimin me Nr.02/67 të datës 26.02.2021, Vendimin me Nr.05/96 të datës 22.06.2016; Aplikacionin e ankuesit G.D të datës 13.04.2023, Diplomën me Nr. 970, Diplomën me Nr.1263, Certifikatën nga UBT 2005/2006, Certifikatën nga Universiteti i Teknologjisë në Vienë e datës 10.11.2006, kopje e ID-së së ankuesit, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.02.2023, Letër motivimin prill 2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 12.03.2008 deri 06.04.2023, Vërtetimin e datës 05.06.2020, Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 10.06.2019, Vërtetimin për përvojën e punës i datës 02.06.2022, Vendimin Ref.DBN-MM-5/77/2023 i datës 01.02.2023, Shkresën e datës 31.05.2012, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 02.03.2023, 31.01.2022, Certifikatën nëntor 2022, Certifikatën tetor 2022, Certifikatën dhjetor 2015, Certifikatën e datës 20.12.2015, Certifikatën e datës 21.11.2013, Certifikatën tetor 2020, Certifikatën për periudhë 23.03.2012 deri 31.05.2012, Certifikatën për periudhën 30.04.2012 deri 22.05.2012, Dëshmi për masat disiplinore të datës 13.04.2023.

Pas shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstatoi se janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave materiale, ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 14.03.2023 ka shpall Konkursin e hapur, me numër të referencës RN00011216, për pozitën “*Sekretar i Përgjithshëm I në Ministrinë e Mbrojtje*”, me afat të aplikimit nga data 13.04.2023 deri më datë 20.04.2023.

Me tej sipas shkresave të lëndës, rrjedhë së në konkursin me numër të referencës RN00011216, kanë aplikuar nëntë (9) kandidatë, kurse sipas listës së ngushtë të datës 27.04.2023, vetëm dy (2) kandidatë kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, rrejdhimisht, ankuesi ishte përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit të kësaj procedurë të pranimit.

Sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 12.09.2023, ankuesi në testin me shkrim ka arritur 39.96 pikë, ndërsa, në intervistë me gojë 36.24 pikë, gjithsej në total 76.2 pikë, ndërsa kandidati tjetër në testin me shkrim ka arritur 35.6 pikë, në intervistë me gojë 28.9 pikë, gjithsej në total 64.5 pikë.

Duke qenë së vetëm një kandidat ka arritur të marr më shumë së 70 pikë, Njësia përgjegjëse në këtë rast Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, më datë 14.09.2023 ka njoftuar kandidatet me rezultate e vlerësimit dhe ndërprerjen e procedurës, me arsyetimin se nuk ka dy kandidatë të suksesshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se meqë konkursi për këtë pozitë është shpall për të katërtën herë, rregullativa ligjore parasheh që vetëm nëse në tri herë radhë rezulton që nuk janë dy kandidat fitues ri përsëritet procesi ndërsa për herën e katër nuk është përcaktuar si të veprohet, duke kërkuar që si analogji të aplikohet si në rastet e procedurave të prokurimit ku përcaktohet se nëse kanë dështuar dy procedura në herën e tretë mund të kryhet edhe me vetëm një operator.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore fillimisht analizoj Konkursin për pranim me numër reference RN00011216 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm I në Ministrinë e Mbrojtjes* dhe për pasojë konstatoi se si kritere formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë: **Arsimi i kërkuar:** *Diplomë/a e arsimit ë lartë me së paku 4 vite të studimeve. E preferuar në fushat që ndërlidhen më fushëveprimtarin e institucionit ku rekrutohet. Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, në funksion të bazushmerisë së pretendimeve ankimore iu referua dispozitave të nenit 40 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil. 2. Konkurrimi organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për çdo institucioni tjetër shtetëror (në vijim Njësia e Pranimit). 3. Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 30 ditë, përpara datës të*

caktuar për paraqitjen e aplikimit, nga Njësia e Pranimit, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. 4. Shpallja e konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, përfshin pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, përshkrimi i punës, kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, që duhet t'i plotësojnë kandidatët, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e konkurrimit, dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim dhe afatin për paraqitjen e aplikimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza: 5.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit, dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e Pranimit, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidatëve, nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese, bëhet nëpërmjet një procedure vlerësimi, që përfshin një testim elektronik dhe një testim me gojë. Në testimin me shkrim sigurohet anonimiteti i konkurrentëve. Komisioni i vlerësimit mund të asistohet në procesin e vlerësimit nga subjekte të specializuara të fushës së përzgjedhjes të burimeve njerëzore. 8. Jo më shumë se tre (3) kandidatët e vlerësuar, nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Me emrat e kandidatëve fitues njoftohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ata bëhen publik nga Njësia e pranimit në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht dhe kanë të drejtën e ankimit në KPMSHCK, në afat kohor 8 dite kalendarike. 9. Në rast se procedura e konkurrimit përfundon pa të paktën dy kandidatë fitues të vlerësuar me më shumë se 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet një procedurë e dytë konkurrimi. Procedura e dytë e konkurrimit është e hapur dhe në të mund të marrë pjesë çdo kandidat, që i plotëson kërkesat e përgjithshme për pranimin në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme për pozitën përkatëse nga brenda apo jashtë Shërbimit Civil. 10. Në rast se edhe procedura e dytë nuk sjell të paktën dy fitues, një procedurë e tretë konkurrimi, gjithashtu e hapur, organizohet pas një periudhe 3 (tre) mujore... 11. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton, me akt nënligjor, rregullat e hollësishme për procedurën e konkurrimit dhe vlerësimin e kandidatëve”.

Po ashtu Kolegji i Këshillit mori parasysht edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përkatësisht me nenin 7 është përcaktuar se: ... 7. Nëse numri i aplikacioneve të pranuarra të kandidatëve është më pak se tre (3), procedura e konkurrimit ndërpritet dhe një procedurë e dytë e hapur e konkurrimit organizohet ku mund të aplikojnë edhe kandidatët jashtë shërbimit civil. Një procedurë e dytë e hapur organizohet edhe në rastet kur së paku dy (2) kandidatë nga kandidatët që kanë aplikuar (tre e më shumë) nuk janë vlerësuar nga komisioni i pranimit, me më shumë se 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit. 8. Në rast se edhe organizimi i procedurës së dytë të konkurrimit si në paragrafin 7 të këtij neni nuk përfundon me të paktën dy kandidat fitues, një procedurë e tretë e konkurrimit, gjithashtu e hapur, organizohet pas një periudhe tre (3) mujore..” ndërsa me nenin 13 të kësaj Rregullore është përcaktuar se: “...15. Komisioni, në bazë të vendimit si në paragrafin 14 të këtij neni përgatit listën e kandidatëve me më shumë se 70 për qind të pikëve dhe renditjen e tyre e bënë duke filluar nga kandidati me më shumë pikë. 16. Jo më shumë se tre (3) kandidatë dhe jo më pak se dy (2) kandidatë të vlerësuar nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 e më shumë për qind të pikëve

të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe bashkë me poentimet e tyre, propozohen, për përzgjedhje përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Në rast të pikëve të barabarta zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e nenit 27 të Rregullores përkatëse për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës”.

Rrjedhimisht, në kuptim të kuadrit ligjor si me lartë, dhe nisur nga fakti së procedura e rekrutimit për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, ka përfunduar me vetëm një kandidat të suksesshëm, përkatësisht, me vetëm një kandidat që ka rritur se paku 70 % të pikëve të përgjithshme, në vlerësimin e Kolegjit, njësia përgjegjëse ka vepruar në pajtim më dispozitat materiale me rastin e ndërprerjes së procedurës mbi bazën se nuk ka dy kandidat fitues, sepse, duke qenë së procedura e rekrutimit për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, është shpallur tri herë radhazi si procedurë e hapur me të drejtë të aplikimit të çdo kandidati, nga brenda apo jashtë Shërbimit Civil, atëherë pas dështimit të procedurës së dytë për përzgjedhje, në çdo rishpallje te pozitës duhet të aplikohen në analogji rrjedhimisht në mënyrë të përshtatshme dispozitat e nenit 40 paragrafi 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e nenit 13 paragrafi 16 dhe 17 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues. Rrjedhimisht mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, nisura nga rrethanat dhe konstatimet si me sipër, e duke bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridik:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1170/2023

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së.